NAMIK DOKLE

DITËT E LAKURIQËVE TË NATËS

ROMAN

BOTIMET TOENA

NAMIK DOKLE

DITËT
E LAKURIQËVE TË NATËS

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Anrila Spahija
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-12-1

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

1

Makina e internimit qëndroi poshtë dritares. Për një imtëkohë ai e mbërtheu vështrimin në anzat e shtrembëruara të saj, pastaj ngriti sytë drejt qiellit dhe pa një kuqëlimë verdhane, që i ngjau si gjak i përzier me qelb. Një qetësi e rrejshme po e vriste brenda vetes dhe ai nuk arriti të lëvrinte asnjë qelizë të trurit, të paktën sa për të menduar diçka për atë mëngjes të qelbëzuar. Asgjë.

E dinte se do ta internonin, një bashkëpunëtor i ri shkencor në Akademinë e Shkencave, që punonte me të, ndoshta nga simpatia për profesorin, apo nga mëshira për të, kishte nxjerrë sekretin, të cilin kushedi se ku e kishte mësuar. Profesor, i tha, më duket, nuk e di sesi dhe pse, ndoshta nuk është e vërtetë, dhe unë dëshiroj të jetë gënjeshtër, por… një i njohuri im atje… në ato zyrat… më tha që kanë marrë vendim për t'ju internuar. Më falni, por nuk e mbajta dot, ka tri ditë që po më bluan kockat ky lajm.

“E di”, u përgjigj shumë thatë ai, vetëm e vetëm për t’i shpëtuar asaj torturës pyetësore, si, kush ta tha, çfarë tha, po atij kush ia tha, ti, a ia ke thënë ndonjë tjetri, këtu në akademi e di njeri, apo jo, e dhjetëra të tjera si këto.

“Ah, e dini?”, foli thuajse pazëshëm ish-studenti i tij, të cilin ai vetë e kishte propozuar për të ardhur në Akademi, si një djalë me talent shkencor. “Më falni profesor!” Ai i vuri dorën në sup, pa e ditur dhe pa e kuptuar mirë pse: për ta qetësuar ish-studentin e tij, apo për të mbajtur veten diku. Ndoshta për të dyja arsyet, ndoshta edhe për një të tretë: për të mbajtur botën që po i rrokullisej mbrapsht, drejt një humbëtire gërmadhash brenda trupit dhe qenies së tij.

E dija, mendoi duke parë makinën, e kisha marrë me mend që ajo valle këtë fund do të kishte. Të paktën unë e hodha vallen time, u përpoq të qetësonte veten… Po Rozana, pyeti veten, do ta marrë vesh ndonjëherë se ku po më çojnë?

Në një ditë të tillë, disa muaj më parë, kishte filluar gjithçka, në një zbardhëllimë të trembur, kur administratori i Akademisë kishte cokatur me rrapëllima në derën e tij dhe si i tromaksur thërriste, hape, hape, hape shpejt!

“Çfarë ka ndodhur?”, pyeti ai, me sy të lodhur nga pagjumësia e natës.

“Alarm shtetëror, ka rënë tërbimi në një fshat të largët dhe nuk i dihet fundi, gjendja është shumë e keqe, thonë, dy kanë vdekur dhe një tjetër ka vrarë nënën e tij.”

“Po unë…”

“Ka urdhëruar Kryeministri, gjeni mikrobiologun më të mirë, ka thënë, merreni edhe nga Franca po të doni, por Kryetari i Akademisë i ka treguar se ti, profesor Reka, je specializuar në Paris dhe… duhet të nisesh menjëherë!”

* * *

Emri i fshatit në fillim iu duk i çuditshëm… Bukojna… Bukojna, “bukë me ojna”, përsëriti disa herë, por pastaj dikush i tregoi se emri vinte nga sllavishtja (si qindra emra të tjerë, mendoi), dhe “bukojnë” do të thoshte ahishtë. Ai që ia bëri këtë shpjegim, duke parë kureshtje në sytë e biologut të famshëm, nisi t’i tregojë edhe disa legjenda. Shkenca dhe legjendat rrinë larg njëra-tjetrës, mendoi.

Për të shkuar në atë fshat nuk kishte rrugë makine, shkuan deri në qendër të krahinës, aty ngarkuan në kuaj të gjitha pajisjet e laboratorit fushor, që biologu i kishte paketuar që në Tiranë. Atje i pritën dy fshatarë, me dy mushka dhe një kalë. Pajisjet i ngarkuan me shumë kujdes në mushka, ndërsa kali mbeti pa gjë.

“Kali është për ju, profesor”, i tha mjeku i qytetit që e shoqëronte. Por ai, i pamësuar, ngaqë kurrë nuk kishte kalëruar, i tha se preferonte të ecte në këmbë. Qenkan bjeshkë të bukura këndej, mendoi, ç’dreq tërbimi paska rënë?

“Si është gjendja?”, pyeti njërin nga fshatarët.

“Çka!”, tha ai dhe biologu nuk e mori dot vesh, nëse ai nuk dinte gjë, apo nuk donte t’i thoshte diçka më shumë.

“Po ai që vrau nënën, ç’pati?”, pyeti përsëri biologu. Fshatari e pa rrëmishtë.

“Askush nuk ka vrarë nënën”, i tha, “në fshatin tonë s’ka ndodhur kurrë ndonjë vrasje, vetëm një pushkatim, qeveria e pushkatoi një mësues, nuk e di pse.”

“Kur ka ndodhur?”

“Po si të them, nja dhjetë a pesëmbëdhjetë vjet të shkuara më duket.”

“Jo, jo, u bënë 14 vjet”, foli fshatari tjetër, “e mbaj mend mirë atë ditë se më lindi vajza, plakat thanë që u tremb nusja dhe e polli para kohe, por shyqyr Zotit, mirë e kam, u rrit.”

Pak më tutje u futën në ahishtë dhe biologu e ndjeu veten në parajsën e asaj që kishte mësuar gjithë jetën, në një areal biologjik të jashtëzakonshëm bimësh dhe gjallesash, zërash dhe shushurimash, drite dhe freskie, që kurrë në jetë nuk i kishte qëlluar t’i shikonte dhe shijonte.

“Si quhet ky pyll?”, pyeti.

“Drobak”, thanë thuajse njëzëri të dy fshatarët.

“Qenka një mrekulli e natyrës.”

“Edhe pak kohë i ka mbetur”, foli fshatari që ecte përpara, dhe me sa duket e kishte emrin Sejdo, se kështu i foli ai tjetri. “Zadefin e Epërm e preu ushtria, na e faroi krejt, tash e ka radhën Drobaku.” Fshatari

që ecte pranë biologut nuk foli dhe as ai nuk pyeti më shumë.

Vetëm kur arritën në fshat dhe një nga ata të këshillit i çoi në një shtëpi që dukej e braktisur, ai e mori vesh se Bukojna ishte shumë pranë kufirit dhe në krye të saj, hijerëndë, qëndronte posta me ushtarët që ruanin dhe mbronin shtetin. Por jo nga tërbimi, mendoi biologu.

"E kujt është kjo shtëpi?", pyeti me zë.

"E Klokos", i tha këshilltari, "u arratis para gjashtë-shtatë muajsh, se nuk donte të dërgonte vajzën në aksionin e hekurudhës së Librazhdit." Ai shikoi me dinakëri fshatarin me emrin Sejdo dhe pastaj iu kthye përsëri profesorit: "E ke të gjithën në dispozicion, shoku shkencar."

"Po kufiri është larg?"

"Një vrap pele", i tha këshilltari dhe u largua.

Profesor Reka e ndjeu veten bosh, si një njeri që e di se e pret një punë e panjohur, të cilën nuk di nga ta fillojë.

2

Pyetja e parë që i bëri të vetmes ndihmësmjekeje që kishte fshati ishte për historinë e sëmundjes, nëse kishte pasur raste të tjera, kur dhe si ishin shfaqur. Por përgjigjja ishte më shumë njëfarë legjende a filozofi popullore sesa një tregues shkencor që mund ta ndihmonte sadopak. Thuhej se dikur (kur, dreqi ta hajë?) një qen i tërbuar kishte kafshuar gjithë fshatin, një fshat pa emër ky, dhe kishte shpëtuar vetëm një familje, në krye të atij grumbulli shtëpish. Kur i treguan të parit të fisit se i gjithë fshati po tërbohej nga kafshimi i qenit, ai i mori njerëzit e fisit për t'i çuar te qeni i tërbuar. "Të na kafshojë edhe ne, se nuk mund të jetojnë në të njëjtin fshat të tërbuarit me të patërbuarit!"

U përpoq të zhbirilonte ndonjë shenjë tjetër për të mësuar se si erdhi dhe nga erdhi sëmundja e re, për të cilën Kryeministri i vendit kishte urdhëruar që ai të vinte deri aty, në skajbotë, por përgjigjet e

ndihmësmjekes ishin të ndrojtura sikur të qe në ndonjë provim përpara profesorit.

"Nuk di ç'të them, disa thonë që kanë parë të fluturojnë ca shpendë të çuditshëm, të tjerë thonë se ra një shi i pistë, si i kuqërremtë përpara sëmundjes, ca të tjerë kanë dëgjuar ca zhurma të pazakonta natën, këta madje shtojnë se ato zhurma vinin nga përtej kufirit, domethënë nga shteti armik që kemi këtu afër, por…", u ndërdysh paksa, "të gjitha këto janë hamendje." Pas pak, thuajse pazëshëm, shtoi: "Janë bërë njerëzit si të përhantë, nuk dinë ç'thonë."

"Sa të sëmurë ka deri tani?"

"Pesë a gjashtë."

"Shkojmë t'i shohim!", fjalët e profesorit tingëlluan si urdhër. Ndihmësmjekja u priu në një shtëpi, jo shumë larg nga ajo e të arratisurit Kloko, në të cilën ishin vendosur profesori i biologjisë dhe mjeku nga qyteti që e shoqëronte. Pa mbërritur në oborr, dëgjuan një rropamë grindjesh dhe zëra grash që vikatnin, njëra më shumë se tjetra. "Ç'ma mbani këtu atë të tërbuar, pse nuk e çoni në spitalin e qytetit a të Tiranës, në dreq të mallkuar po deshët, por hiqeni që këtu, se do na marrë në qafë të gjithëve", thërriste njëra. "Mbylle gojën, moj dërdule, e di unë ku e mbaj djalin tim!", përgjigjej tjetra dhe tërhiqej drejt derës së shtëpisë.

"Atëherë më paguaj gjelin që ma vrau i tërbuari yt", thirri tjetra.

"E sa të bëka ai kanxhi yt zëçjerrë?"

“Sa një sahat floriri më bën! Gjeli ishte sahati im që më zgjonte mëngjes për mëngjes, tani më jepni sahatin tuaj!”

“Posi, posi, pse nuk thua të të japim kaun për një gjel?”, u përgjigj fqinja e saj, por kur pa ndihmësmjeken me dy burra, i dha fund grindjes menjëherë. “Urdhëroni, futuni brenda!”, i ftoi. Biologu u habit nga ky kapërcim, ky sublimim, mendoi, nga grindja me fqinjën në përzemërsi me të ardhurit nga larg.

“Si është djali?”, pyeti.

“Nuk di ç’të them, çuditshëm.”

Atij i bëri shumë përshtypje ajo fjalë “çuditshëm”. Nuk tha as rëndë, as rrezik, as aman doktor, por thjesht dhe vetëm “çuditshëm”. Djalin e gjetën në një dhomë të vogël në katin e dytë, jo në shtrat, por ulur në një karrige pranë dritares, duke vështruar fragmente malesh që dukeshin përballë. Profesori po e shikonte vëmendshëm, por ai nuk lëvizi dhe as nuk u foli të sapoardhurve, madje as nuk e hoqi vështrimin nga peizazhi përtej dritares. Paaftësi për të lëvizur trupin dhe konfuzion shpirtëror, mendoi profesori për një nga shfaqjet e zakonshme të sëmundjes.

“Ka frikë nga uji?”, pyeti nënën e të sëmurit.

“Nuk e di, nuk më ka thënë gjë dhe lumin e kemi larg”, tha ajo.

“Kam frikë nga nata!”, tha djali dhe nuk e hapi më gojën; të gjitha pyetjeve të tjera u përgjigj e ëma, me aq sa dinte. Kur e pyeti nëse kishte lëvizje të dhunshme ajo i tregoi rastin e gjelit të fqinjës, e

pa që kishte hyrë në kopshtin tonë dhe e qëlloi me gurë në kokë, ndoshta edhe pahiri. Pa dashje, e sqaroi ndihmësmjekja. Ndërsa pyetjes, nëse djali i saj kishte përpëlitje të pakontrolluara, ajo iu përgjigj se sillej gjithë ditën nëpër dhomë si kali në lëmë, nuk donte të fliste me asnjeri dhe me zor i fuste dy lugë kos në gojë.

"Vaksinën ia keni bërë?"

"Po", u përgjigj shkurt ndihmësmjekja.

"Mirë, do të vijmë përsëri, për çdo shqetësim na lajmëroni", i tha nënës së të sëmurit, pastaj iu kthye "doktoreshës", siç dëgjoi ta quanin ndihmësmjeken. "Merrini një kampion pështyme, ta shohim në laborator!"

Rrugës për tek i sëmuri i dytë, akoma mendonte për të parin. Më tepër anonte te melankolia e thellë, megjithëse kishte disa shenja të tërbimit akut. Por tek i dyti u shqetësua edhe më shumë, kur i thanë se kishte pasur një rast të humbjes së vetëdijes. Ah, mendoi, pas kësaj vjen humbja e jetës, dhe dha urdhër për një terapi intensive.

Kur u nisën për tek i sëmuri i tretë, në rrugë u dolën dy ushtarë të armatosur dhe i ndaluan.

"Do të vini me ne në postë!", tha njëri prej tyre, në mënyrë aq të vendosur, sikur t'i kishte zbritur ato fjalë nga qielli.

"Çfarë poste, nuk kam letër për të marrë dhe as për të dërguar", tha profesori.

"Keni thyer regjimin e kufirit", tha ushtari.

"Çfarë?"

“Profesori ka ardhur këtu me urdhër të Kryeministrit”, u përpoq ta qetësonte mjeku i qytetit, por ushtari nuk hante pykë në trungun e vet.

“Edhe unë me urdhër të Kryeministrit veproj”, tha më këmbëngulës se më parë, “urdhri është që çdo qytetar që vjen në fshat të paraqitet në Postën e Kufirit pastaj…”

“Pastaj, çfarë?”, pyeti profesori.

“Dorëzon pasaportën dhe lejen për të ardhur në fshat, pastaj vazhdon punën.”

“Punë dreqi!”, tha profesori në frëngjisht, i kishte mbetur ajo shprehje që kur ishte për specializim në institutin *Pasteur*.

“Ne as leje nuk kemi marrë!”, u përpush mjeku i qytetit.

“Mos u shqetësoni”, tha ndihmësmjekja, “po thërras Stalinin, i rregullon ai këto punë.” Ajo u nis për te një shtëpi aty afër, ndërsa ushtarët u ndjenë më të qetë, pasi dëgjuan emrin e Stalinit.

“Pas tërbimit edhe Stalini na duhej”, mendoi profesori. Pas pak ndihmësmjekja u kthye bashkë me një burrë hollak e me flokë ngjyrë gruri të stërpjekur, midis të kuqes dhe të verdhës. Profesorit iu kujtua ajo kuqëlimë verdhane e mëngjesit, kur e urdhëruan të nisej për në atë fshat fundbote.

“Shoku këshilltar, ne…”, foli mjeku i qytetit.

“Nuk ka gjë, punë që rregullohen, por këto janë urdhrat e regjimit të kufirit, e kemi armikun një vrap pele larg.”

“Dhe?”, u mat të pyeste diçka profesori, por Stalini, ose ai që kishte atë nofkë, ia preu fjalën në mes.

“Dhe në kufi s’mund të fluturojë asnjë harabel pa lejen tonë, shoku shkencar”, i tha.

“Shkencëtar!”, e korrigjoi mjeku nga qyteti.

“Nuk ndryshon guri i mullirit, pse ndryshon ngjyra e ujit”, i tha ai që kishte emrin Stalin dhe vetëm në ato fjalë profesori u kujtua se ishte po ai këshilltari që i kishte futur në shtëpinë e të arratisurit dhe me një emër të çuditshëm, Kloko.

“Domethënë kufirin nuk e kalon dot asnjë harabel?”, pyeti.

“Vetëm minjtë dhe kërmijtë.”

“Po dhelprat e kuqe?”, pyeti përsëri profesori.

Tjetri u nxi dhe u ndie i fyer.

“Ç’punë keni ju me dhelprat e kuqe?”

“Janë një nga bartësit më të rrezikshëm të virusit të sëmundjes, këndej nga ju më kanë thënë që nuk ka shumë, por andej kufirit janë shumë të përhapura dhe…”, profesori pati dëshirë të bënte një shpjegim të zgjeruar të lidhjes së sëmundjes me dhelprat e kuqe, t’u tregonte se në vendet e Europës Perëndimore me avionë të vegjël hidhen në pyje miliona paketa me vaksina për dhelprat e kuqe, por njeriu me emrin Stalin e ndërpreu përsëri.

“Dje e kontrolluam brezin e butë, nuk ka asnjë gjurmë dhelpre!” Profesori nuk e dinte çfarë ishte brezi i butë, por hamendësoi që bëhej fjalë për diçka që kontrollonte kufirin midis dy shteteve.

“Aq më mirë!”, tha i kënaqur që kishte marrë një informacion të saktë e të dobishëm për punën që kishte ardhur të bënte aty. Megjithatë duhet ta shikoj

edhe vetë, mendoi. Dorëzuan pasaportat ushtarëve, u përshëndetën me këshilltarin dhe u nisën për të parë të sëmurët e tjerë.

"Ç'pati ai që u turbullua?", pyeti ndihmësmjeken.

"Profesor, mos u shqetësoni, ju nuk kishit nga ta dinit se ashtu e quajmë në fshatin tonë, Skilja e Kuqe e Bukojnës."

"Po emri Stalin?", pyeti mjeku.

"Ohu! Ka vite që i ka mbetur, që kur ishte Stalini gjallë thonë, por unë nuk e di pse, ndoshta askush nuk e di, e kanë harruar. Po ju më mirë i thoni Salko, kështu e thërrasin të gjithë."

Profesor Reka, mikrobiologu më i mirë i vendit, siç e quanin nëpër korridoret e Akademisë dhe të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, e ndjeu veten të mjerë, të shtrydhur nga çdo ndjesi. Dhe as nuk e kuptonte arsyen pse.

3

I sëmuri i tretë dukej pothuajse i paralizuar dhe pamja e tij, mbërthyer në dhimbje e ofshama, e trembi profesor Rekën. Por kur e ekzaminoi me hollësi, nuk gjeti asnjë shenjë tërbimi, ndërkohë që i sëmuri mezi po mbante veten për të mos ulëritur nga dhimbja, i vinte zor nga të ardhurit.

"Kur të filluan këto dhimbje?"

Ai nuk foli.

"Parmbrëmë, vonë", i tha babai i tij. "As ne nuk e dimë nga i erdhi."

"Lëre, o baba, nuk jam i sëmurë si të tjerët unë, kam thyer brinjët, nuk kam gjë tjetër", foli djali.

Doktori u përkul mbi të dhe ia preku brinjët me radhë, dukej që djaloshit i therte çdo e prekur, ishte nxirë në fytyrë dhe ishte gati të thërriste gjithë engjëjt e qiellit për t'ia lehtësuar ato të therura të tmerrshme.

"Katër brinjë të thyera", tha doktori duke u ngritur.

“Çfarë të ka ndodhur, mor bir, pse s’na ke treguar asgjë?”, e pyeti një plakë, që nuk kuptohej nëse e kishte djalë apo nip brinjëthyerin. Qenka tharë si ara në brinjë, mendoi biologu për atë plakë të shkretuar nga jeta.

“U rrëzova nga shkalla, prandaj nuk tregova”, tha djali.

Profesori u habit. Çfarë injorance, mendoi, rrëzohet tjetri nga shkalla, thyen brinjët dhe qafën dhe nuk tregon, e përse? Nuk arrij ta kuptoj.

“Dërgojeni urgjentisht në qytet!”, urdhëroi dhe doli pa u përshëndetur me njerëzit e shtëpisë. Doktori e ndoqi. “Po ky hija që më vjen nga pas, nuk di të flasë?” Qysh se e takoi për herë të parë, iu fiksua mania e doktorit për të tundur kokën pas çdo fjale të tij dhe heshtja pothuajse e plotë. Ndoshta e ka nga droja përpara autoritetit tim shkencor, por të luash mumien nuk është shprehje respekti, mendoi ai.

Ndihmësmjekja u vonua dhe ai ndezi një cigare, shpuza e së cilës i kujtoi se po errej. Thithi me ashk dhe ndjeu nikotinën t’i depërtonte në brendësi të mushkërive.

“Ku do të shkojmë tani?”, pyeti ndihmësmjeken, kur doli nga shtëpia e brinjëthyerit. Kishte kureshtje ta pyeste edhe për arsyen e vonesës së saj, por nuk ra në atë grackë vogëlsirash.

“Ku do të shkojmë tani?”, rimori pyetjen e tij ndihmësmjekja. “Asgjëkund nuk shkojmë dot tani”, tha e mllehur.

“Pse?”, pyetën thuajse në një gojë profesori dhe doktori.

“Po erret dhe pas pak vajzat ndalin këngën e futen ndër avllia, burrat lënë në mes bisedat e nisura dhe fshati mbytet në errësirë.”

“Ç’po na torollis kështu?”, u nevrikos doktori.

“Pas pak minutash fillon ndalimqarkullimi në fshat!”, tha ajo prerë dhe ftohtë. Dukej e fyer nga fjalët e doktorit, por në fund të fundit, ç’faj ka ai, nga ta dijë se si është jeta këtu në kufi, mendoi. Pa e kuptuar as vetë arsyen, profesori hodhi cigaren e sapondezur.

“Ç’domethënë kjo?”

“Është regjimi i kufirit, profesor. Kur bie nata, në fshat nuk mund të qarkullojë askush pa lejen e postës kufitare, përveç ushtarëve dhe pushkatarëve. Edhe ata që marrin leje, duhet të lëvizin me fener të ndezur që të duken, ndryshe…”

“Çfarë ndryshe?”

Ndihmësmjekja me një zë të qetë dhe pa ndonjë farë emocioni i shpjegoi gjithë ato rregulla të ftohta e të metalta që përfshinte togfjalëshi “regjimi i kufirit” dhe të cilin profesori nuk e kishte dëgjuar më përpara se të vinte në atë fshat. E dinte mirë, madje e kishte parë edhe vetë gjatë një konference në Berlin, atje ekzistonte *Chec point Charli* që ndante si me thikë qytetin, ku ditë e natë kontrollonin ushtarët e katër fuqive të botës, por ama kurrë nuk kishte dëgjuar për ato farë rregullash shqiptarçe që po u tregonte Rozana. Metastazat e Murit të Berlinit, mendoi.

Rregullat zbatoheshin në të gjithë fshatrat e kufirit. Askush, edhe po të kishte lindur në atë fshat, nuk mund të vinte nga qyteti pa lejen e Degës së Brendshme,

“qoftë edhe për të parë gjyshen e sëmurë”, tha ajo hidhtas. Banorët e fshatrave kufitare kishin pasaporta të “Zonës A” dhe duhet t’i mbanin gjithnjë me vete. Asnjë fshatar nuk mund të afrohej deri 800 metra pranë kufirit pa lejen e komandantit dhe, kur merrnin leje të kositnin livadhet, të nxirrnin patatet, apo të bënin ndonjë punë tjetër, dy ushtarë rrinin aty afër dhe vëzhgonin çdo lëvizje të tyre. Shumë familje kanë të afërmit matanë, shtoi ajo, unë kam tezen e babit për shembull, por kur ata vijnë afër kufirit dhe na flasin, ne e kemi të ndaluar t’u përgjigjemi. Njëherë tezja që kemi matanë martoi djalin dhe nusja, sipas zakonit, bëri dhuratë një palë çorape edhe për babin tim, por si të na i jepnin? Kur e panë babanë tim duke kositur livadhin, i hodhën çorapet në ferra dhe i thirrën: “I ke dhuratë nga nusja e Halilit.”

Ata nuk folën dhe Rozana mendoi se dëshironin të dëgjonin diçka më tepër. “Natën askush nuk duhet të lëvizë. Por më keq e kanë djemtë. Nuk di a keni dëgjuar, apo jo, por këtu në fshatin tonë martesat bëhen me njohje dhe me dashuri. Kur një vajzë dhe një djalë shikohen me simpati, vajza i dërgon një tufë me karafila të bardhë dhe kur ai i pranon, ditën tjetër ajo i dërgon një tufë me karafila të kuq.”

“Si ia dërgon?”, nuk e përmbajti dot kureshtjen profesori.

“Çdo mbrëmje, vajzat mblidhen pranë portave të mëdha. Këtu në Bukojna mblidhen në shtatë porta, që janë anës Julicës, rrugës së madhe, dhe djemtë shëtisin që nga Bërce e deri te Guri i Çekiçit, duke

dëgjuar këngët dhe romuzet e vajzave. Kur kalojnë aty pranë, marrin karafilat. Dikur vajzat këndonin deri vonë, tani regjimi i kufirit nuk i lejon, i mbyll shumë shpejt brenda. Por më e keqja është se janë ndaluar edhe dritaret, dalja në dritare. Ah, nuk e kuptove profesor? Nuk e di prej sa kohësh ekziston ky zakon, kam pyetur edhe gjyshen, edhe në kohën e saj ashtu ishte… Kur djali merr karafila të kuq nga një vajzë, ai i tregon së pari motrës dhe ajo nënës dhe babait. Kur një nuse e mëhallës shkon në shtëpinë e prindërve, familjet e djemve të dashuruar dërgojnë pogaçe dhe dhurata të tjera në familjet e vajzave."

"I çon nusja nëpër shtëpitë e tyre?"

"Jo, jo, nusja është vetëm sebepi, i themi ne. Ajo përcillet me këngë grash dhe vajzash për në shtëpinë e prindërve dhe në këtë rast motrat apo të afërmet e tjera të djemve, duke shoqëruar nusen, dërgojnë edhe dhuratat për vajzat që duan vëllezërit e tyre. Kështu familja e vajzës merr vesh se dikush ia ka vënë syrin. Pas disa ditësh, kur po ajo nuse kthehet në shtëpinë e burrit, shoqërohet nga vajzat apo nuset që u kthejnë dhuratat djemve. Në këtë rast ka vetëm një dhuratë, një palë norta për opinga. Në qoftë se familja e vajzës ka pranuar djalin, dërgon norta të bardha për të, por kur nuk e pranon, dërgon norta ngjyrë rozë, të cilat përdoren nga femrat."

"Po pastaj?", pyeti doktori ndërsa profesori ndërdyshej dhe s'dinte ç'të thoshte; sa bukur, apo çfarë budallallëqesh!

"Pastaj djemtë fillojnë të dalin në dritare", tha Rozana.

“Pse dalin në dritare, çfarë bëjnë?”, nuk u përmbajt profesori.

“Jo në dritaren e tyre, por në dritaren e vajzës. Shkojnë natën, vënë shkallët dhe ngjiten te dritarja ku i pret e dashura. Ka nga ata që bisedojnë deri në mëngjes, sidomos në ditët e para të dashurisë.”

“Mirë e the pak më parë, e paskan keq djemtë!”, tha profesori duke ndezur një cigare të dytë.

“E keqja nuk u vjen nga dashuria”, tha ndihmësmjekja.

“Nga u vjen?”

“Nga regjimi i kufirit. Që kur u arratis ai Klokoja me kuç e me maç, asnjë djalë nuk lejohet të dalë në dritare. Urdhër nga komanda: ndal dritare! Edhe më përpara ka pasur ndalime të tilla, por tashti sikur e kanë shtrënguar më fort obruçin.”

“Pse?”, pyeti doktori.

“Se ai Klokoja, mirë që u arratis, por shkoi e gjeti ditën që në Tiranë bëhej Kongresi i Partisë. Në ditët e Kongresit rojet dyfishohen, bashkë me ushtarët dalin të ruajnë fshatin edhe pushkatarët, sa janë, shtatë a tetë. Ishin nëntë, por pasi u arratis Kloko, mbetën tetë, se edhe ai vetë ishte pushkatar. Pushkën ua la në brezin e butë.”

“Ah!”, bëri profesori dhe nuk dinte ç’të thoshte tjetër.

“E dini ku i ka thyer brinjët ai djali që vizituam?” Ata ngritën supet.

“Shkeli rregullin dhe shkoi në dritare, por, sapo kishte filluar të fliste me vajzën, u dëgjuan kërcitjet e

gozhdëve të ushtarëve në kalldrëmin e fshatit. Duke zbritur me nxitim që mos ta kapnin, u rrëzua dhe theu ato brinjët që numërove ti, doktor."

Nuk e kishin vënë re se ndihmësmjekja, duke u treguar gjithë ato rregulla e zakone, i kishte sjellë deri te shtëpia e Klokos, ku qe vendosur laboratori fushor dhe ku do të flinin ata të dy. E kishte gllabëruar errësira atë shtëpi të braktisur, dukej vetëm porta e ndriçuar nga një fener. Kur u afruan, silueta që mbante fenerin, lëvizi drejt tyre.

"A u lodhët?", i pyeti dhe profesorit iu duk zë i njohur. "Kaq shpejt do të filloj dialogun e hijeve?", pyeti veten. Asnjeri nuk dha përgjigje për pyetjen e fshatarit.

"Ky është daja im", tha ndihmësmjekja. "Ju ka sjellë këtë fenerin sa për sonte, nesër do të shikojmë për ndonjë llambë."

"Nuk ka dritë elektrike?", u habit profesori.

"Ka vetëm posta e kufirit, zyrat e kooperativës dhe zyra e komandantit, gjeneratori është i vogël…", foli fshatari.

Profesori u kujtua për atë zë.

"Ti na solle nga qendra e lokalitetit?", pyeti.

"Mushka ime ju solli", tha fshatari dhe profesori nuk e kishte të vështirë të dallonte ironi dhe tallje në atë zë. Por pastaj toni i zërit u zbut, kur i ftoi të shkonin atë natë në shtëpinë e tij. "Nuk keni as çfarë të hani, mensa e kooperativës është e mbyllur në darkë", tha për t'i dhënë një fortesë logjike ftesës që po u bënte. Por profesori nuk pranoi. "Do të rrimë aty

ku na la Stalini", deshi të thoshte, por në imtëkohën e atij mendimi u pendua dhe nuk foli.

Kushedi si e marrin këta që i hedhin fjalët si çiftja saçmat, dreqi e di se ku të kapin… Doktori e mori fenerin dhe u nis drejt shtëpisë së Klokos. "Natën e mirë!", tha profesori dhe u fut brenda. Nuk pati fuqi as të dëgjonte nëse dikush prej tyre ia ktheu përshëndetjen. Akoma pa rregulluar shtretërit për t'u shtrirë (oh, sa natë e gjatë do të jetë sonte!), u dëgjuan të trokitura në derë. E hapi doktori dhe profesori dëgjoi zërin e ndihmësmjekes.

"Nanëdaja e kishte përgatitur për ju flinë, nuk e di a do ju pëlqejë."

"Oh, flija e famshme e Gorës!", u dëgjua thirrma e doktorit.

"Kalofshi mirë dhe mos u trembni nga qentë, u lehin ushtarëve." Doktori u kthye brenda dhe shploi tepsinë e flisë, ndërkaq profesori ndjeu aromën e këndshme të gjalpit të shkrirë.

"Ke ngrënë ndonjëherë fli, profesor?"

"Ra ky tërbim që ta provoj edhe flinë."

4

U përpoq të lexonte diçka në dritën e zbehtë të fenerit, por shumë shpejt sytë e lodhur filluan t'i mbylleshin dhe ai u fut në rrobat e shtratit. Mendoi se do ta zinte gjumi, pas gjithë asaj dite të lodhshme, por shumë shpejt e ndjeu se ajo errësirë e ngjeshur e dhomës nuk do ta linte të mbyllte sy. Dritëza e veremtë e fenerit i jepte errësirës një pamje të çuditshme si prej ekrani, në të cilin profesori filloi të shikonte copëza të jetës së vet.

Hera e fundit që kishte fjetur në dhomë pa dritë elektrike ishte në moshën njëmbëdhjetë vjeç, në shtëpinë e tij të largët, diku në jug të vendit. Pastaj shkoi në shkollat e qyteteve, tetëvjeçare, gjimnaz, në fakultetin e Shkencave dhe pastaj… në Paris, bashkë me tre shokë të tjerë të fakultetit, të përzgjedhur nga studentët më të mirë për të vazhduar studimet në universitetet franceze, dy për matematikë, njëri për fizikë dhe ai vetë për biologji. Ata janë mirë, vetëm mua më kapi tërbimi që të shikoj edhe njëherë botën

pa dritë, mendoi. Duke ia ngulur sytë errësirës së dhomës, brenda vetes shikonte dritat e Parisit, hera-herës i dukej sikur miliarda qeliza të gjakut të tij ishin bërë si miliarda llambushka dritash që lëvrinin nën qiellin e *Champs-Elysée-së* në natën e Krishtlindjeve. Por shumë shpejt e mbyti përsëri errësira dhe ai kujtoi në frëngjisht dy vargje, si ulërimë shpirti, *nuk ka gjë më të dhimbshme sesa të kujtosh gëzimin në ditë të mjeruara*. Çudi, mendoi, kam harruar ku i kam lexuar. Te Hygoi, apo Lamartini, ndoshta tek Aragoni. Një grimë nga kujtesa e tij i thoshte që mund t'i kishte lexuar te Dantja, por pse dreqin m'u kujtuan në frëngjisht, kurse Danten e kam lexuar vetëm në shqip, kur isha në gjimnaz.

Gërhima e doktorit, të cilin e kishte zënë gjumi kaherë, ia nxori nga kujtesa e shtresëzuar fletën e bardhë ku i kishte lexuar ato fjalë, ato dy vargje. O Zot, çfarë shëmtie apoetike që një gërhimë si e matanëbotshme të të kujtojë ato dy perla poezie… *nuk ka gjë më të dhimbshme sesa të kujtosh lumturinë në ditë të mjeruar.* Të vetmet fjalë në një fletë të bardhë. Fjalë të vrara, apo vrastare. As tani nuk mund ta thoshte me siguri. Madje, atëbotë, po pyeste veten nëse Mili i kishte shkruar për vete, apo për atë, ato dy vargje të qëndisura me mëndafshin e një poeti, të cilin nuk po e kujtonte dot. Me siguri nga njëri prej poetëve që parapëlqente Mili, vajza parisiene, e para e kësaj bote që e kishte puthur diku në *Shanzelize* dhe e kishte çuar në një botë të tjetërllojshme, krejt ndryshe nga kjo e këtejshmja dhe e andejshmja bashkë. Ah, Mili, më fol tani, më thuaj ti ndonjë fjalë që të mos e dëgjoj këtë gërvimë

të ndryshkur njerëzore. Por asnjë zë tjetër nuk e depërtonte errësirën e asaj dhome.

Vetëm errësirë dhe gërhitje.

Dashuria e tij me Milin kishte filluar nën një shi të ngrohtë parisien, i kishte zënë papritur, siç vijnë gjithnjë shirat e pranverës, ai kishte nxjerrë xhakaventon për të mbuluar kokën e vajzës dhe aty nën atë xhakavento të lehtë, zbriti engjëlli i puthjes së parë. Nuk pati guximin të rikujtojë gjithë ditënetët e dashurisë, por kujtoi vetëm breshrin e asaj mbrëmjeje kur e thirrën në ambasadë, në *Rue de la Pompe Nr.131* dhe ambasadori, me një zë të qetë por të thartë i tha, djalë, partia të ka dërguar në Francë për t'u bërë i dobishëm për atdheun e jo për dashuriçka. Kokrrat e breshrit binin si saçma në qelqet e dritareve dhe ai ndiente se si ato po e vrisnin. Nisi në një shi të ngrohtë dhe përfundoi në një breshër therës. Thuajse e kishte humbur vetëdijen, kur dëgjoi fjalët e fundit të ambasadorit, e di ti që ajo është përzier edhe në demonstratat e majit? ("O tmerr, edhe unë shkova dy herë me të!") Kështu që zgjidh e merr, ose lëre këtë Milin (edhe emrin ia paskan gjetur e shkruar në atë copë letër), ose të paketojmë për në Tiranë. Qartë?! Shumë qartë: të paketojmë për në Tiranë dhe kaq! Kaq dhe asgjë më: *duro zemër, se s'do hapur goja!* Pastaj ajo letërza, me ato dy vargje, me ato dy fjalë… nuk ka gjë më të dhimbshme sesa të kujtosh shiun e ngrohtë, kur bie breshër… breshër… bre… bre… breshër… bër… bër… bër… gërr... gërr… gërr, vazhdonte doktori dy metra larg tij. Zuri veshët me jastëk, por u ndie edhe më keq sepse myku i nënkresës e mbyti në grykë.

“Ç’dreqin do të jetë kjo sëmundje?”, pyeti veten dhe u përpoq që t’u shmangej vramendjeve të tjera. Ata që pashë kanë plot shenja të sëmundjes së tërbimit, por seç më hijezoi edhe diçka tjetër që s’po e kap dot çfarë është, ndoshta do të na thonë nesër analizat e gjakut. Edhe po të jetë tërbim, që me siguri është, urgjentisht duhet të gjej shkakun, dreq o punë, duhen parë të gjithë qentë dhe macet e fshatit, ka apo nuk ka të infektuar, për fat po t’u besoj fjalëve të Stalinit, dhelpra e kuqe nuk na ka ardhur prej matanë kufirit, por ku i dihet? Edhe një do të ishte boll për këtë fshat të vogël. “Fluturuan ca shpendë të çuditshëm.” Iu kujtua fjala e njërës prej plakave që takoi gjatë vizitës së të sëmurëve. E kishte thënë edhe Rozana. A mos janë lakuriqë nate që i janë dukur të çuditshëm? Dhe, në fund të fundit, duhet pyetur ajo plakë nëse i ka parë me sy apo ka dëgjuar nga tregimet e të tjerëve. Gjithë ato përsiatje për sëmundjen, ndoshta edhe pse doktori e kishte mehur gërhitjen, dhe biologun po e zinte gjumi.

Dhe nuk ishte aspak e çuditshme që pa një ëndërr të cilën kurrë nuk e kishte parë herë tjetër. Një burrë i gjatë, i veshur me smoking të zi e mori për dore dhe po e udhëhiqte në korridoret e institutit *Pasteur* të Parisit, mbante një fener në dorën e majtë, instituti ishte i zhytur në errësirë. Më njeh mua, e pyeti burri dhe afroi fenerin pranë fytyrës së vet… Fytyrë e parë më dukesh, i tha ai. Jam profesor Frashëri, studiuesi i tërbimit në Shqipëri, kam ardhur këtu që bashkë me ty të gjejmë rrënjët e asaj sëmundjes. Futemi në laboratorin e të madhit Pasteur. Dëgjo, edhe është, edhe nuk është

tërbim, më dëgjo të them, më dëgjo. Laboratori qenka mbytur në pusin e errësirës, dreqi e mori, dhe ky feneri nuk po bën më dritë… sikur të kishim dy, një të ndezur, një të fikur… ama dëgjomë mua, edhe është, edhe nuk është tërbim, Milin nuk e zuri, ty të zuri. Po, po, thirri ai nëpër gërbellat e gjumit, m'u shkoq trupi nga kruajtjet, janë shenja e parë e tërbimit, plasa, plasa, kush ka një rrjetë teli të më kruaj?

Sapo u zgjua, vuri re që dora e tij po kruante qafën. Alarmi i kruajtjes, mendoi. E ndjeu alarmin në të gjithë trupin, i kruhej qafa, gusha, gjoksi, çdo pjesë e zbuluar e gjymtyrëve madje kishte kruajtje edhe për rreth syve. Futi dorën poshtë nënkresës dhe mori çakmakun, kur e ndezi u çmend nga ajo që pa, një lukuni tartabiqesh lëviznin për t'iu larguar dritës së dobët të ndezësit të cigares. Verbazi futeshin nën dyshek, nëpër cepat e dërrasave të vjetra të krevatit, nëpër muret e dhomës. Me fundin e ndezësit shtypi njërin dhe ndjeu menjëherë erën e keqe, të mprehtë dhe mbytëse. Kërceu nga krevati dhe qëndroi në mes të errësirës së dhomës. Doktori gërhiste. Dreq, i ka trembur gërhima e këtij trapi që nuk po e pickojnë? Pati një dëshirë që të merrte një grusht me tartabiqe nga krevati i tij dhe t'ia hidhte doktorit në qafë, por menjëherë e ndjeu veten mjeran prej asaj dëshire. "Duhen shtypur tartabiqet që na qeverisin!", dëgjoi zërin e Milit që vinte nga maji i vitit 1968. Më vonë, ajo u bë parullë e të gjithë studentëve, por ai nuk shkoi më me ta... Ose lëre këtë Milin, ose të paketojmë për në Tiranë, për në Bukojna, dreqi e mori. E ç'rëndësi ka? Njëlloj është.

5

Për fat të mirë, vetëm disa hapa e ndanin shtëpinë e të arratisurit nga një çezmë e vogël, matanë rrugës. Profesori nxori një peshqir dhe sapun nga çanta e madhe e rrobave dhe shkoi të shpëlahet. Uji rridhte në një koritë të vogël prej druri, të punuar trashë, por gjithsesi, mërmërima e currilit të ujit i zgjoi një ndjesi të mirë në atë mëngjes të murrmë dhe me kutërbim tartabiqesh. Pasi u shpëla dhe fërkoi me ujë të freskët pikëzat e infektuara ku e kishin pickuar "ato kafshë të ndyra", piu një gllënjkë ujë, iu duk shumë i lehtë. "Kafshë të ndyra", përsëriti edhe njëherë, sepse fjala insekt i dukej shumë e butë për ato dreq tartabiqesh. Iu nëpërmend edhe profesori i mikrobiologjisë në Paris që i quante "kafshë" disa nga mikrobet, kur ua demonstronte në mikroskopin e laboratorit. Duhet të montoj menjëherë pajisjet e laboratorit tim dhe të filloj nga analizat, pa ato s'mund të gjej asgjë të saktë për këtë sëmundje të djallëzuar. Kështu i quanin